
EFFECT OF PLANTING DEADLINE IN EARLY PRODUCTION AND YIELD OF TOMATO IN SUN GREENHOUSES

NDIKIMI I AFATEVE KOHORE TË MBJELLJES SË DOMATËS NË HERSHMËRI DHE RENDIMENT NË SERRA DIELLORE

ISUF LUSHI¹, LLAZAR HAXHINASTO², NEXHAT BALAJ³

1. SHFKP "Anadrini" Xerxë, Kosovë,

2. Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëria,

3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë-Kosovë.

apanorama@hotmail.com

AKTET V, 3: 474-480, 2012

PERMBLEDHJE

Domatja është nga bimët perimore më të rëndësishme dhe më e përhapur në Kosovë. Në studim janë marrë hibridet e domatës Amati dhe Big-beef, ku janë hulumtuar gjithësejt tri variante dhe katër afate të mbjelljes (afati i parë, afati i dytë, afati i tretë dhe afati i katërt). Gjatë studimit janë ndjekur dhe analizuar treguesit: ecuria e fazave fonologjike, treguesit biometrik të bimë dhe frutit, lulet e çelura dhe frutat e lidhur, treguesit e hershmërisë, dinamika e prodhimit në kushtet e serrës diellore në regjionin e Anadrinit, Kosovë. Skema e ngritjes së eksperimentit ishte "blloku i randomizuar" me 4 përsëritje me dy kultivar. Lartësia e bimë në (cm) te variantet rezulton në kufi nga 200.5 cm te hibridi Amati, ndërsa 198.75 cm te hibridi Big-Beef. Treguesit e hershmërisë së varianteve në prodhim, te hibridi Amati varianti i parë ka terguar hershmeri më të lartë në krahasim me variantet tjera, po ashtu edhe te hibridi Big-beef varianti i parë ka terguar hershmëri më të lartë në krahasim me variantet tjera. Vertetohet se rendimenti i përgjithshëm më i lartë, tek dy hibridët e hulumtuar, është konstatuar te varianti i dytë respektivisht te afati i dytë, Amati (1937kv/ha) dhe te hibridi Big Beef, rendimenti më i lartë është terguar te varianti i parë respektivisht afati i parë i mbjelljes (2040.10 kv/ha).

Fjalë kyçe: Domate, afatet kohore, hershmëria, rendimenti, prodhimi.

SUMMARY

Tomato hybrids under study were Amati and Big-beef, whereas investigation was undertaken in four variants (first time of planting, the second term, third term and fourth term). During our investigation we have monitored and analyzed the following indicators: biometric indicators of plant and fruits, indicators of earliness of variants, dynamic of production in sun greenhouses in the region of Anadrini, Kosovo. The experiment has been set up according to randomized block design in four replication. Plant height (cm) of tomato plants in different variants resulted within the range of 200.5cm (Amati), and 198.75 cm (Big-Beef). As for the earliness of production of variants in production, with regard to hybrid Amati the first variant (black plasmas) showed the highest earliness compared to other variants. The same trend was recorded to Big-beef as well. It was proved that the highest total yield, has been recorded to the second variant (the second term) and the value was 1937 q/ha (Amati) and 2040.10 q/ha Big-beef. (The first option ie the first time planting).

Key words: Tomato, earliness indicator, dynamic of production.

HYRJE

Kultivimi i domates ne serra diellore është një veprimtari aktive fermerëve në bujqësi, duke

pasur parasysh edhe investimet financiare. Serrat diellore gjithashtu mundësojnë rritjen e shpejta të bimëve, shfrytëzimin e tyre prodhuese neper

mjet kontrollit , ku qëllimi është optimizimi i treguesve tokësor e klimatik me kërkesat biologjike të bimëve.

Prodhimi në serra diellore hasë në një varg vështirësish, për zgjidhjen e të cilave është e nevojshme ndërmarrja e një sërë studimesh, të orientuara drejt vlerësimit të treguesve të efektivitetit të prodhimit në mjedise të mbrojtura, në raport me atë të fushës së hapur, përmirësimit të teknologjive të prodhimit, aplikimit të sistemeve të prodhimit dhe mbrojtjes së integruar, përmirësimit të marketimit të prodhimit, etj. (BALLIU, 1999).

Nëpërmjet zbatimit të teknologjive të reja dhe të prodhimit të domates në serra diellore si: kontrolli i mikroklimës, ngritjes së vllajave, mulqerimit në serrë, shfrytëzimi i plehrave kristalor, zbatimi i ujitjes pikë pikë, zbatimi i mbrojtjes preventive nga sëmundjet dhe dëmtuesit etj., ndikojnë në shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve prodhuese të domates.

Domatja është njëra nga perimet e cila për drejtimet e shumta të përdorimit dhe destinacionit i përgjigjet mirë kërkesave në vazhdimësi të konsumatorit. Për arsye të tilla kultivimi i saj është rritur në mënyrë të dukshme në këto vite të fundit duke zgjeruar njëkohësisht edhe kalendarin e prodhimit, si rrjedhojë e zgjerimit të saj në serra diellore.

Në Kosovë ky është studim i parë që është ndërmarrë për të hulumtuar Ndikimin e afateve kohore të kultivimit të domates si në hershmëri ashtu edhe në rendiment në serra diellore.

MATERIALI DHE METODAT E PUNËS

Dy hibride të domates (Amati dhe Big Beef) me origjinë Holandeze janë mbjellur në serrën diellore në regionin e Anadrinit në fshatin Radostë (Rahovec). Për hulumtimin tone u morën në studim ndikimi i afateve kohore të kultivimit të domates në hershmëri dhe rendiment në serra diellore me dy hibride (Amati dhe Big-Beef) dhe katër variante (afati i parë, afati i dytë, afati i tretë dhe afati i katërt). Farat u mbollën në module plastike, me torfë industriale. Fidanët e gatshëm u mbollën në serrë në 16/03, 26/03,

06/04 dhe 16/04 për tre vitet e hulumtimit (2006, 2007 dhe 2008).

Distancat e mbjelljes të aplikuara ishin 100 x 40 cm dhe me një dendësi të mbjelljes së bimëve prej 2.5 bimë/m². Skema e mbjelljes së eksperimenteve ishte në katër përsëritje sipas varianteve për çdo eksperiment.. Gjatë eksperimentimit me kujdes janë mbajtur shënimet fenologjike dhe matje biometrike. Prodhimi i gatshëm u vol dhe u peshua për secilin nga njësitë eksperimentale, në përputhje me periudha të caktuara kohore. Të dhënat e prodhimit u konvertuan në kv/ha dhe shërbyen si të dhëna bazë për punë të mëtejshme.

Gjatë këtyre hulumtimeve janë ndjekur dhe analizuar treguesit e mëposhtëm:

Shënimet fenologjike: data e mbjelljes së farës, data e mbirjes, mbjelljes në serrë, data e gonximit, data e lulëzimit sipas lulërive, data e lidhjes së frutave, përçindja e lidhjes së frutave, data e pjekjes së frutave, Treguesit biometrik të bimës dhe frytit, lulet e çelura dhe frutat e lidhur, treguesi i hershmërisë së hibrideve, rendimenti sipas periudhave të vjeljes (kv/ha), dinamika e prodhimit (kv/ha).

Hibridet në studim

1. Amati: Është hibrid indeterminant, i hershëm, frutat me ngjyrë të kuqe intensive të peshës mesatare 205.40 gr, pesha mesatare për bimë 7.43 kg, rendimenti për hektar 1847.80 kv/ha. Është atraktiv për treg. I qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Frutat e tij janë me uniformitet të lartë. Është hibrid i Kompanisë "Semini." Holandë.

2. BigBeef: Është hibrid indeterminant, i hershëm, frutat me ngjyrë të kuqe, me peshë mesatare 229.70 gr, pesha mesatare për bimë 7.87 kg, rendimenti për hektar 1970 kv/ha. I qëndrueshëm ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Është hibrid i Kompanisë "Peto-seeds." Holandë.

REZULTATET E HULUMTIMIT

Nga rezultatet e hulumtimeve trevjeçare (2005-2008) të kryera në serrën diellore, dy hibride të domates (Amati dhe Big-Beef) me origjinë nga Holanda të mbjellura në serrën diellore, në

regjionin e Anadrinit në fshatin Radostë-Rahovec, është konstatuar se prodhimi i realizuar nga domatja e kultivuar në kushtet e serrave është shumë i lartë.

Shënimet fenologjike

Për të krijuar një ide mbi kalimin e fenofazave të hibrideve të domates në kushtet klimatike

tokësore të serrës ku është ngritur eksperimenti u regjistruan disa të dhëna të cilat janë: Mbjellja e farës për katër afatet është realizuar në datat 16.01, 26.01, 06.02 dhe 16.02.

Ndërrimi i fidanit në serrë për katër afatet është realizuar në datat 16.03, 26.03, 06.04 dhe 16.04.

| Hibridet | Raporti H/D | Trashësia e epikarpit (mm) | Numri i dhomëzave | Pesha mesatare e frytit (gr) |
|----------|-------------|----------------------------|-------------------|------------------------------|
| Amati | 0.85 | 0.40 | 5 | 205.40 |
| Big-Beef | 0.80 | 0.35 | 5.5 | 229.70 |

Tabela 1. Treguesit biometrik të frytit të domates

| Hibridet | Lartësia e bimës (cm) | Lartësia e K.I nga toka (cm) | Distanca midis K.III-IV (cm) | Trashësia e kërcellit (cm) |
|----------|-----------------------|------------------------------|------------------------------|----------------------------|
| Amati | 200.5 | 22.50 | 20.6 | 1.40 |
| Big-Beef | 198.75 | 24.50 | 19.2 | 1.45 |

Tabela 2. Treguesit biometrik të bimës domates

| Afati | Hibridi | Numri luleve të çelura | Numri i frutave të lidhur | % e frutave të lidhur kundrejt luleve të çelura | Mesatarja |
|-------|----------|------------------------|---------------------------|---|--------------------|
| I | Amati | 962 | 822 | 85.45% | Amati 84.48% |
| | Big-Beef | 848 | 712 | 83.96% | |
| II | Amati | 940 | 798 | 84.90% | |
| | Big-Beef | 871 | 717 | 82.23% | |
| III | Amati | 966 | 815 | 84.37% | Big-Beef 82.02% |
| | Big-Beef | 857 | 687 | 80.16% | |
| IV | Amati | 900 | 749 | 83.22% | |

Tabela 3. Lulet e çelura dhe frutat e lidhur te domatja (mesatarja trevjeçare 2006-2008)

Nga tabela 4 shihet se janë konstatuar dallime në rendiment te hibridi i domates Amati varësisht nga afati i mbjelljes, varianti (plasmasi) dhe viti i hulumtimit. Rendimenti më i madh i frutave të vjelura të domates është konstatuar afati i dytë mbjelljes (276.80), më i vogël te afati i katërt (247,87), ndërsa te afati i parë dhe i tretë i

mbjelljes rendimenti ka qenë 271.54 respektivisht 259.44 kv/ha.

Në mbështetje të analizës së variancës dhe testit me LSD, nuk janë konstatuar dallime sinjifikante statistikore në mes afateve të mbjelljes, sa i përket rendimentit te domates te hibridi Amati dhe konstatojmë se dallimet e konstatuara kanë qenë vetëm dallime të rastit.

| Afati (A) | Varianti (B) | Viti (C) | Mesat. | | | | | |
|-----------------|------------------|----------|-----------|-----------|-------------------------------|--------|--------|---------|
| | | | (AxB) | (A) | | | | |
| | | 2006 | 2007 | 2008 | | | | |
| <i>I</i> | Plasmas i zi | 304.14 | 257.26 | 334.40 | 298.60 ** | | | |
| | Plasmas i bardhë | 265.41 | 234.54 | 282.19 | 260.71 Ns | | | |
| | Pa plasmas | 270.38 | 218.57 | 277.00 | 255.32 Ns | | | |
| | Mesat. (AC) | 279.98 | 236.79 | 297.86 | | | | |
| <i>II</i> | Plasmas i zi | 303.31 | 246.80 | 317.69 | 289.27 * | | | |
| | Plasmas i bardhë | 276.56 | 245.85 | 293.33 | 271.91 | | | |
| | Pa plasmas | 275.72 | 235.21 | 296.75 | 269.23 | | | |
| | Mesat. (AC) | 285.20 | 242.62 | 302.59 ** | | | | |
| <i>III</i> | Plasmas i zi | 314.79 | 211.14 | 334.64 | 286.86 | | | |
| | Plasmas i bardhë | 277.14 | 209.04 | 273.16 | 253.11 | | | |
| | Pa plasmas | 247.85 | 200.27 | 266.94 | 238.35 | | | |
| | Mesat. (AC) | 279.93 | 206.82 | 291.58 | | | | |
| <i>IV</i> | Plasmas i zi | 272.09 | 220.96 | 308.00 | 267.02 | | | |
| | Plasmas i bardhë | 252.29 | 206.18 | 260.44 | 239.64 * | | | |
| | Pa plasmas | 303.89 | 183.86 | 223.14 | 236.96 ** | | | |
| | Mesat. (AC) | 276.09 | 203.67 ** | 263.86 | | | | |
| | | C1 | C2 | C2 | Mesat. (B) | | | |
| Mesat. (BxC) | Plasmas i zi | 298.58 | 234.04 | 323.69 ** | 285.44 ** | | | |
| | Plasmas i bardhë | 267.85 | 223.90 | 277.28 | 256.34 Ns | | | |
| | Pa plasmas | 274.46 | 209.48 ** | 265.96 | 249.96 ** | | | |
| Mesat. (C) | | 280.30 | 222.47 ** | 288.97 ** | Interaksioni (A xB x C) ** | | | |
| FAKTORËT | A | B | C | AB | AC | BC | ABC | |
| LSD | 1 % | 103.684 | 27.304 | 33.580 | 59.922 | 73.694 | 62.288 | 157.759 |
| | 5 % | 78.768 | 20.743 | 25.510 | 44.026 | 54.144 | 46.169 | 106.630 |

Tabela 4. Rendimenti kv/ha te hibridi Amati (ANOVA)

Dallime sinjifikante statistikore të niveleve të ndryshme janë konstatuar edhe në mes varianteve të hulumtuar (Faktori B). Vlera më e lartë e rendimentit të domates te hibridi Amati është konstatuar te varianti me plasmas të zi (285.44), ndërsa më e ulët te varianti pa plasmas (249.96). Kjo vlerë e rendimentit të hibridit Amati te varianti me plasmas të bardhë është 256.34. Në pikëpamje të rendimentit te varianti me plasmas të zi në njëjërë anë si dhe te varianti pa plasmas në anën tjetër dallimet statistikore të konstatuara janë tejet sinjifikante, kurse në mes të variantit me plasmas të bardhë dhe atij pa plasmas nuk janë konstatuar dallime sinjifikante

dhe se dallimet e konstatuara janë vetëm dallime të rastit. Gjithashtu nuk janë konstatuar dallime statistikore në mes të domateve të kultivuara me plasmas të zi dhe atyre me plasmas të bardhë. Në pikëpamje të rendimentit të domates, në mes të viteve të hulumtimit (Faktori C) njëherësh janë konstatuar dallime tejet sinjifikante statistikore ku vlera më e lartë është konstatuar gjatë vitit 2008 (288.97) kurse më e vogël gjatë vitit 2007 (222.47). Dallimet e konstatuara sa i përket rendimentit në mes të vitit 2008 dhe 2006 me rendimentin e vitit 2007 janë tejet sinjifikante ndërsa në mes vitit 2008 dhe 2007 nuk janë

konstatuar dallime statistikore sa i përket rendimentit.

Nga ana tjetër sa i përket interaksioneve gjegjësisht bashkëveprimit të faktorëve siç janë:

A x B, A x C, B x C dhe A x B x C po ashtu janë konstatuar dallime statistikore të niveleve të ndryshme të sinjifikacionit.

| Afati (A) | Varianti (B) | Viti (C) | Mesat. (AxB) | | | Mesat. (A) | | |
|-----------------|------------------|----------|-----------------|-----------|-----------|---------------|-------------------------------|---------|
| | | | 2006 | 2007 | 2008 | | | |
| I | Plasmas i zi | | 354.04 | 231.18 | 389.61 | 324.94 ** | | |
| | Plasmas i bardhë | | 293.59 | 207.89 | 327.04 | 276.17 | 291.52 Ns | |
| | Pa plasmas | | 272.96 | 225.26 | 322.07 | 273.43 | | |
| | Mesat. (AC) | | 306.86 | 221.44 ** | 346.24 ** | | | |
| Mesat. (B) | | | | | | | | |
| II | Plasmas i zi | | 335.18 | 245.32 | 338.46 | 306.32 | | |
| | Plasmas i bardhë | | 289.07 | 248.25 | 274.29 | 270.54 | 288.85 Ns | |
| | Pa plasmas | | 298.21 | 256.36 | 314.54 | 289.70 | | |
| | Mesat. (AC) | | 307.49 | 249.98 | 309.09 | | | |
| Mesat. (B) | | | | | | | | |
| III | Plasmas i zi | | 329.89 | 267.50 | 337.79 | 311.73 | | |
| | Plasmas i bardhë | | 306.36 | 237.79 | 293.71 | 279.29 | 285.67 Ns | |
| | Pa plasmas | | 263.39 | 227.89 | 306.71 | 266.00 | | |
| | Mesat. (AC) | | 299.88 | 244.39 | 312.74 | | | |
| Mesat. (B) | | | | | | | | |
| IV | Plasmas i zi | | 309.57 | 245.46 | 311.71 | 288.92 | | |
| | Plasmas i bardhë | | 254.86 | 241.96 | 254.14 | 249.99 | 259.75 Ns | |
| | Pa plasmas | | 243.18 | 237.82 | 240.05 | 240.35 ** | | |
| | Mesat. (AC) | | 269.20 | 241.75 | 268.30 | | | |
| Mesat. (B) | | | | | | | | |
| Mesat. (BxC) | Plasmas i zi | | 332.17 | 247.37 | 344.39 ** | 307.98 ** | | |
| | Plasmas i bardhë | | 285.97 | 233.97 ** | 287.05 | 268.99 * | | |
| | Pa plasmas | | 269.44 | 236.83 | 295.84 | 267.37 ** | | |
| | Mesat. (C) | | 295.86 Ns | 239.39 ** | 309.09 ** | | Interaksioni (A xB x C) ** | |
| FAKTORËT | A | B | C | AB | AC | BC | ABC | |
| LSD | 1 % | 96.794 | 29.804 | 31.291 | 65.408 | 68.669 | 58.041 | 147.004 |
| | 5 % | 73.533 | 22.642 | 23.771 | 48.057 | 50.453 | 43.021 | 99.361 |

Tabela 5. Rendimenti kv/ha te hibridi Big-Beef (ANOVA)

Nga tab.5.shihet se te hibridi i domates Big-Beef janë konstatuar dallime në rendiment varësisht nga afati i mbjelljes, varianti (plasmasi) dhe viti i hulumtimit. Rendimenti më i madh i frutave të vjelura të domates është konstatuar te afati i parë i mbjelljes (291.52), më i vogël te afati i katërt (259,75), ndërsa te afati i dytë dhe i tretë i mbjelljes rendimenti ka qenë 288.85 respektivisht 285.67kv/ha.


Në mbështetje të analizës së variancës dhe testit me LSD, nuk janë konstatuar dallime sinjifikante statistikore në mes afateve të mbjelljes, sa i përket rendimentit te domates te hibridi Big-Beef dhe konstatojmë se dallimet e konstatuara kanë qenë vetëm dallime të rastit.

Dallime sinjifikante statistikore të niveleve të ndryshme janë konstatuar edhe në mes varianteve të hulumtuar (Faktori B). Vlera më e

lartë e rendimentit të domates te hibridi Big-Beef është konstatuar te varianti me plasmë të zi (307.98) ndërsa më e ulët te varianti pa plasmë (267.37). Kjo vlerë e rendimentit të hibridit Big Beef te varianti me plasmë të bardhë është 268.99. Në pikëpamje të rendimentit te varianti me plasmë të zi dhe te varianti pa plasmë në njërin si dhe te varianti me plasmë të zi dhe ai me plasmë të bardhë në anën tjetër dallimet statistikore të konstatuara janë tejet sinjifikante, kurse në mes të variantit me plasmë të bardhë dhe atij pa plasmë nuk janë konstatuar dallime sinjifikante dhe se dallimet e konstatuara janë vetëm dallime të rastit. Nuk janë konstatuar dallime statistikore edhe në mes të domateve të kultivuara me plasmë të zi dhe atyre me plasmë të bardhë.


Në pikëpamje të rendimentit të domates, në mes të viteve të hulumtimit (Faktori C) njëherësh janë konstatuar dallime tejet sinjifikante statistikore ku vlera më e lartë është konstatuar gjatë vitit 2008 (309.09) kurse më e vogël gjatë vitit 2007 (239.39). Dallimet e konstatuara sa i përket rendimentit në mes të vitit 2008 dhe 2006 me rendimentin e vitit 2007 janë tejet sinjifikante ndërsa në mes vitit 2008 dhe 2007 nuk janë konstatuar dallime statistikore sa i përket rendimentit.

Nga ana tjetër sa i përket interaksioneve gjegjësisht bashkëveprimit të faktorëve siç janë: A x B, A x C, B x C dhe A x B x C po ashtu janë konstatuar dallime statistikore të niveleve të ndryshme të sinjifikacionit.



Grafiku 1. Hershmëria e prodhimit sipas varianteve, (kv/periudhë vjeljeje) te hibridi Amati dhe Big-Beef

Nga grafi 1 sa i përket hershmërisë së prodhimit sipas varianteve, kv/periudhë të vjeljes është konstatuar se hibridi Big-Beef i kultivuar me plasmë të zi ka hershmëri më të lartë, me një rendiment prej 67.82 kv/ha/periudhën e parë. Gjithashtu edhe hibridi Amati me plasmë të zi ka dhënë rendiment të lartë (52.49 kv/ha/periudhën e parë të vjeljes). Te kontrolla (pa plasmë) të dy hibridët, Amati dhe Big-Beef, kanë dhënë rendimentin më të ulët 12.29 respektivisht 13.05 Kv/ha. Kjo analize është e rëndësishme për të vlerësuar ndikimin e hibrideve në periudhat me çmimin më të lartë në treg.



Grafi 2. Rendimenti sipas hibrideve dhe afateve të mbjelljes kv/ha

Nga paraqitja grafike e dinamikës së prodhimit (Graf. 2), shihet se rendimenti i përgjithshëm më i lartë, te të dy hibridët e hulumtuar, është konstatuar te varianti i parë respektivisht me plasmë të zi, Amati (1998kv/ha) dhe Big Beef (2156 kv/ha), pastaj në radhë vijnë variantet e tjera.

PËRFUNDIME

Prodhimi i domates në serra diellore është një biznes rentabil, prej te cilit shoqëria ka perfitime materiale nga prodhimi i realizuar.

Te treguesi i hershmërisë sipas varianteve, kv/periudhë të vjeljes, është konstatuar se hibridi Big-Beef i kultivuar me plasmë të zi ka hershmëri më të lartë, me një rendiment prej 67.82 kv/ha/periudhën e parë. Gjithashtu edhe hibridi Amati me plasmë të zi ka dhënë rendiment të lartë (52.49 kv/ha/periudhën e parë. Te kontrolla (pa plasmë) të dy hibridët (Amati dhe Big-Beef),

kanë dhënë rendimentin më të ulët përkatësisht 12.29 dhe 13.05 Kv/për periudhën e parë.

Sa i përket afateve të mbjelljes rendimenti më i lartë është realizuar te hibridi i domates Amati në afatin e dytë të mbjelljes me rendiment 1937.60kv/ha, ndërsa te hibridi i domates Big-beef kjo është realizuar në afatin e parë të mbjelljes me rendiment 2040.13kv/ha.

LITERATURA

[1] Balliu, A.2004. Mjediset e mbrojtura. Tiranë.

[2] Lushi I, 2004. "Studimi i disa hibrideve të domates në mjediset e mbrojtura në Kosovë dhe

problemet e kultivimit të tyre" Punimi i Magjistraturës, Tiranë.

[3] Koni F.1989. Bazat teorike-eksperimentale të disa hallkave të teknologjisë së kultivimit të domates në mjediset e mbrojtura, Tiranë.

[4] Lushi, I., et al., 2008. The study of the hybrids of tomato in sun greenhouses in Kosovo. For Balkan symposium on vegetables and Potatoes. 9-12 September 2008 .Plovdiv-Bulgaria.

[5] Lushi I, 2009. Studimi i disa hallkave të teknologjisë së kultivimit të domates (*solanum lycopersicum* L.) në serra diellore në Kosovë .